

“BTP Oil” SH.P.K.

Banjë, Vushtrri



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PËRPUNIMIN,
THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E GURIT TË FORTË**

Qershor - 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
PËRPUNIMIN, THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E GURIT TË
FORTË**

"BTP Oil " SH.P.K., Vushtrri

Parcela me numër: 00005-0, Zona kadastrale Banjë

Investitori:	"BTP Oil" SH.P.K.
Personi i Autorizuar:	Burim Hasani
Adresa:	Rruga Hajzer Hasani, p.n Banjskë - Vushtrri
Lokacioni:	Vushtrri
Tel:	+383 48 – 400 - 100
Email:	burim.btpoil@gmail.com

Hartuese e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Emri:	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Email:	Blerinabajraktari1@gmail.com Blerinabajraktari3@gmail.com
Tel:	+383 49 588 634
Nr. i Licencës:	07/20

"BTP Oil" SH.P.K.

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Qershor - 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	5
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	6
3.	VENDNDODHJA E IMPIANTIT PËR PERPUNIM, THËRMIM DHE SEPERIMIN E GURIT TË FORTË	7
3.1	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	9
3.2	Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative të Impiantit të përpunim, thërmim dhe seperimit të gurit të fortë	10
3.3	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	11
3.4	Kapaciteti dhe Përmasat e Impiantit	13
3.5	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit	14
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT, THËRRMIT DHE SEPERIMIN E GURIT TË FORT	14
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	16
5.1	Klima dhe Temperatura	17
5.2	Karakteristikat Hidrografike	18
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	18
6.1	Ndikimet në ajër	19
6.2	Ndikimet në tokë	19
6.3	Ndikimet në ujë	19
6.4	Ndikimet në peizazh	20
6.5	Ndikimet në Florë dhe faunë	20
6.6	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	20
6.7	Ndikimet nga zhurma	21
6.8.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	21
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	22
8.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	23
9.	PERSHKRIMI I MASAVE	24
9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	24
9.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	25
9.3.	Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë.....	25
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	26
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	26
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	27
9.7.	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	28
9.8.	Menaxhimi i mbeturinave.....	28
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	29
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	29

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	31
13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE.....	32

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1 Shtirja hapësinore e Lokacionit ku do të vendoset Impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimit të Gurit të Fortë	7
Figura 2 Parcelat ku do të vendoset Impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimim e Gurit të Fortë	7
Figura 3 Lokacioni ku do të ndërtohet i Impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të Gurit të Fortë	8
Figura 4 Lokacioni i ku do të vendoset Impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të Gurit të Fortë në raport me shtëpitë e banimit.....	8
Figura 5. Skema e Procesit Teknologjik të Punës	13

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1. Tabela e madhësisë se fraksioneve te prodhuara nga përpunimi, thërrmimi dhe seperimi i rërës i gurit të fortë.....	10
Tabela 2. Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës.....	21
Tabela 3.Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	29

1. HYRJE

Bazuar në nenin 11 dhe shtojcën 4 të Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si dhe përmbushjen e kushteve për përpunim, thërrmim dhe seperim i gurit të fortë, kompania “BTP Oil” SH.P.K. me lokacion në Banjë, komuna e Vushtrrisë, ka filluar përgatitjen dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për përpilimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

“BTP Oil” SH.P.K. është kompani e themeluar në Komunën e Vushtrrisë që nga viti 2023, e cila ka planifikuar në instalimin e një linje për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë. Ky projekt është planifikuar të Vendoset në parcelën me nr. 00005-0, zona kadastrale Banjë të cilën e posedon në shfrytëzim kompania. Ky raport paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për Impiantin e përpunimit, thërrmimit dhe seperimin e gurit të fortë, me qëllim që të identifikohen dhe të analizohen ndikimet në mjedis për tërë veprimtarinë e impiantit duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari.

Në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e ndërtimit të impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperim të gurit të fortë si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin impiantit, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me hartimin e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë realizimit të impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Bazuar në karakteristikat e Impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është bazë kryesore ligjore ku jemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina,
- Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L -261

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet , mënyrat ,parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikoj për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. VENDNDODHJA E IMPIANTIT PËR PERPUNIM, THËRMIM DHE SEPERIMIN E GURIT TË FORTË

Impianti i përpunimit, thërmimit dhe seperimit të gurit të fortë me të gjitha pajisjet përcjellëse është planifikuar të vendoset në zonën e shfrytëzimit që e posedon kompania në ngastrën kadastrale me nr. 00005-0 në zonën kadastrale Banjë, komuna e Vushtrrisë.




Figura 1 Shtrirja hapësinore e Lokacionit ku do të vendoset Impianti për përpunim, thërmim dhe seperimit të Gurit të Fortë




Figura 2 Parcelat ku do të vendoset Impianti për përpunim, thërmim dhe seperim e Gurit të Fortë




Figura 3 Lokacioni ku do të ndërtohet i Impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të Gurit të Fortë
Në afërsi të lokacionit ku do të ndërtohet Impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë nga kompania “BTP Oil” SH.P.K., nuk ka shtëpi banimi afër impiantit, distanca me e afërt me shtëpi banimi është mbi 459.06 m,




Figura 4 Lokacioni i ku do të vendoset Impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të Gurit të Fortë në raport me shtëpitë e banimit

3.1 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Impianti do të ndërtohet në parcela me numër 00005-0, zona kadastrale Banjë, komuna e Vushtrrisë. Sipërfaqja e implantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimitit të gurit të fortë përfshin një hapësirë të vogël për instalimin e makinerive, depozitimin e gurit të fortë, si dhe për infrastrukturën e nevojshme administrative dhe logjistike. Vendndodhja e implantit është 5.7 km larg qytetit të Vushtrrisë.

Përshkrimi i veçorive fizike të projektit përfshin disa aspekte kyçe që lidhen me terrenin, ndërtimin e infrastrukturës dhe organizimin e implantit, si dhe shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve të avancuara për realizimin e proceseve të përpunimit, thërrmimit dhe ndarjes së gurit të fortë. Impianti i ”BTP Oil” SH.P.K. është projektuar për të përpunuar, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë në mënyrë efikase dhe të sigurt. Më poshtë janë përshkruar elementët kryesorë të këtij impianti:

1. **Objekti i administratës** i cili përbehet prej hapësirave të zyrave, kuzhinës, dhoma e ndërrimit, banjo/wc.
2. **Linjat e Përpunimit** - Hapësira ku grumbullohen guri i fortë përpara procesit të thërrmimit dhe ndarjes. Këto depo janë të dizajnuara për të mbajtur materialin në kushte të sigurta dhe të organizuara. Hapësira për materialet e ndara, të cilat janë të gatshme për t'u shitur ose transportuar për përdorim të mëtejshëm. Këto depo janë të organizuara sipas klasifikimit të materialeve.
3. **Pajisjet e Përpunimit dhe Sepërimit** - Pajisje të specializuara që thërrmojnë dhe përpunojnë materialet, duke siguruar përgatitjen e saktë për ndarjen.
4. **Hapësirat e Infrastrukturës** - Zona të dedikuara për parkimin e automjeteve të punës dhe për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të përpunuara, që sigurojnë fluks të pandërprerë të operacioneve. Infrastrukturë që garanton hyrjen dhe daljen e sigurt të automjeteve, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve.
5. **Masat e Sigurisë**
 - **Pajisje Mbrojtëse Personale (PPE):** Të detyrueshme për stafin për të garantuar sigurinë në punë.
 - **Trajnime të Rregullta për Sigurinë:** Pjesë e politikës për ruajtjen e një ambienti të sigurt.
 - **Sistemet e Evakuimit Emergjent:** Të dizajnuara për të siguruar një dalje të shpejtë dhe të sigurt në rast emergjence.

- **Mbrojtja nga Zjarri:** Sisteme të avancuara që përfshijnë sensorë zjarri, detektorë tymi dhe aparate shuarje, për të garantuar mbrojtjen e stafit dhe strukturave.

3.2 Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative të Impiantit të përpunim, thërrmim dhe seperimit të gurit të fortë

Faza operative e impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë përfshin një sërë veçorish dhe procese që sigurojnë funksionimin efikas dhe efektiv të impiantit. Kjo fazë përfshin gjithë proceset që lidhen me marrjen, përpunimin dhe ndarjen e materialeve të papërpunuara deri në prodhimin e materialeve të gatshme, si dhe mbikëqyrjen e performancës dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Kompani nuk ka zone të eksploatimit, dhe për këtë arsye kompania do të bëjë blerjen e gurit të fortë nga kompani tjera të cilat kanë licencë nga KPMM.

Veçoritë Kryesore të Fazës Operative:

- Pranimi dhe Inspektimi** – Guri i fortë të cilat pranohen nga kompanitë tjera do të inspektohen për të siguruar që ato janë të përshtatshme për përpunim, thërrmim dhe seperim dhe nuk përmbajnë materiale të rrezikshme apo kontaminuese.
- Thërrmimi dhe seperimi** - Materiali i pranuar do të kalojë nëpër makineritë e thërrmimit për të reduktuar madhësinë e tyre dhe për të përgatitur materialet për procesin e mëtejshëm të ndarjes. Materialet e thërrmuara do të kalojnë nëpër pajisje të specializuara për ndarjen e materialeve bazuar në përbërjen dhe madhësinë e tyre.

Ndarja do të bëhet në fraksione:

Tabela 1. Tabela e madhësisë së fraksioneve të prodhuara nga përpunimi, thërrmimi dhe seperimi i rërës së gurit të fortë

Nr.	Fraksionet	Granulometria (mm)
1.	I	0.4 (mm)
2.	II	0.8 (mm)
3.	III	8.16 (mm)
4.	IV	16.32 (mm)

- Depozitimi dhe Magazinimi** - Materialet e gurit të fortë do të depozitohen në hapësira të dedikuara për magazinimin e fraksioneve.
- Transporti dhe Shitja** - Materialet e seperuara do të ngarkohen në automjete të përshtatshme për transport dhe do të dërgohen tek klientët, përfshirë ndërtuesit, rrugët dhe kompani të tjera që përdorin gurin e fortë. Impianti do të ketë një ekip të dedikuar për marketingun dhe shitjen e produkteve të gurit të fortë.

- c) **Menaxhimi i Mbeturinave dhe Efikasiteti Operativ** - Gjatë procesit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë, do të krijohen disa mbeturina të cilat do të menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme.

Për të siguruar një operim të qëndrueshëm dhe efikas, impianti do të përdorë teknologji më të reja dhe moderne dhe praktika të mira menaxheriale. Kjo përfshin përdorimin e sistemeve të avancuara për monitorimin e procesit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe trajnimin e rregullt të stafit.

- d) **Masat e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit** - Puna në impiant do të kryhet duke respektuar të gjitha rregulloret e sigurisë në punë. Punëtorët do të pajisen me pajisje mbrojtëse personale (PPE) dhe do të ndjekin procedurat e sigurta të punës. Impianti do të zbatojë masat për minimizimin e ndikimit në mjedis, përfshirë përdorimin e sistemeve të filtrimit të ajrit për të reduktuar ndotjen dhe menaxhimin e duhur të ujërave të përdorura. Përpjekje të vazhdueshme do të bëhen për të përmirësuar eficiencën energjetike dhe për të reduktuar mbetjet e pa riciklueshme.
- e) **Trajnimi dhe Zhvillimi i Stafit** - Stafit do të marrë trajnime të rregullta për të siguruar njohuri dhe aftësi të përditësuara në lidhje me teknologjitë e reja dhe praktikatat më të mira në industrinë minerare. Investime në zhvillimin profesional të stafit për të ngritur nivelin e shërbimit dhe për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të impiantit. Këto veçori kryesore të fazës operative të impiantit të përpunim, thërrmim dhe seperimit të gurit të fortë sigurojnë një proces të qëndrueshëm, efikas dhe miqësor me mjedisin, duke mbështetur qëllimin për të minimizuar mbetjet dhe për të promovuar ri-përdorimin e materialeve në sektorin e ndërtimit dhe infrastrukturës.
- f) **Lënda e parë dhe lënda ndihmëse** - Lënda e parë është guri i fortë, ndërsa si lëndë kryesore ndihmëse do të jetë energjia elektrike dhe uji për uljen e ndotjes nga pluhuri.

3.3 Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë nga kompani "BTP Oil" SH.P.K., përfshinë disa faza teknologjike të avancuara dhe përdorimin e makinerive të specializuara. Ky proces është i ndarë në disa faza kryesore që përfshijnë përgatitjen e materialit, prerjen, ndarjen dhe përpunimin e mëtejshëm të gurëve të fortë.

1. Furnizimi dhe Grumbullimi i Gurit të Papërpunuar - Furnizimi me gur të fortë është faza e parë e procesit dhe përfshin marrjen e materialeve nga kompani tjera, të cilët sigurojnë gurë të papërpunuar të llojeve të ndryshme. Ky guri shpesh herë vjen në formë të mëdha dhe të papërpunuara, të cilat kërkojnë përpunim të mëtejshëm për t'u bërë të përdorshëm në industri.

Pas mbërritjes në impiant, materialet kalojnë përmes një faze inspektimi, ku kontrollohen për të siguruar që ato nuk përmbajnë defekte të dukshme si plasaritje të thella, boshllëqe ose përbërje të papërshtatshme që mund të ndikojnë në procesin e përpunimit.

2. Thërrmimi i Gurit në Gurthyes - Një fazë e rëndësishme në procesin e përpunimit të gurit është thërrmimi i gurit në gurthyes. Ky proces është esencial për të thyer lidhjet e forta mes mineralëve të gurit dhe për të lehtësuar ndarjen e tij në pjesë më të vogla, të përshtatshme për aplikime të ndryshme. Gurthyesi është një pajisje mekanike që përdor forcën fizike për të thyer dhe grimcuar materialin e gurit. Thërrmimi në gurthyes bëhet përmes një procesi mekanik të forcës dhe presionit, që e bëjnë të mundur copëtimin e materialit. Ky proces është i njohur për reduktimin e madhësisë së gurit, duke ndihmuar në krijimin e copave të vogla që do të kalojnë përmes proceseve të tjera të ndarjes.

3.Ndarja e Gurit nëpër Fraksione - Pas procesit të thërrmimit në gurthyes, guri kalon në një fazë tjetër të rëndësishme të përpunimit, që është ndarja nëpër fraksione. Ndarja e gurit në fraksione të ndryshme është një hap kyç që siguron që materialet të jenë të përshtatshme për aplikime të ndryshme, duke siguruar efikasitet dhe cilësi të lartë në përdorimin e tyre. Guri kalon përmes sistemeve të sita dhe ekraneve vibrante, të cilat përdorin lëvizje mekanike për të ndarë materialin sipas madhësive të ndryshme të kërkuara. Këto sisteme kanë mundësinë të ndajnë materialin në fraksione të ndryshme, duke siguruar që secili grup materialesh të jetë i përshtatshëm për përdorim të veçantë. Fraksionet e ndara janë si më poshtë:

- **Fraksioni 0-4 mm:** Ky është fraksioni më i vogël, dhe përdoret për beton, mbushës rrugësh, dhe për stabilizimin e sipërfaqeve të ndërtimit.
- **Fraksioni 4-8 mm:** Përdoret në prodhimin e betoneve dhe për ndihmës në ndërtimin e rrugëve dhe strukturave të tjera.
- **Fraksioni 8-16 mm:** Ky fraksion mund të përdoret për ndihmës në ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës dhe gjithashtu në prodhimin e materialeve dekorative dhe përplasjeve për fasada.
- **Fraksioni 16-32 mm:** Ky është një fraksion më i madh, i përdorur për ndihmës në ndërtimin e objekteve të forta dhe për krijimin e mbushjeve të thella për rrugë dhe për projekte që kërkojnë material të fortë dhe të qëndrueshëm.

4. Kontrolli i Cilësisë dhe Inspektimi - Pas çdo faze të përpunimit, është e domosdoshme të kryhet një inspektim rigoroz i cilësisë për të siguruar që produktet përmbushin standardet e

kërkuara. Gjatë ndarjes, çdo copë guri mund të kontrollohet për të verifikuar integritetin e tij, duke siguruar që nuk ka plasaritje të padëshiruara ose ndonjë dëmtim që mund të ndikojë në përdorimin final të materialit. Ky kontroll mund të përfshijë inspektimin vizual, testime mekanike për të verifikuar qëndrueshmërinë dhe forcën e gurit, si dhe përdorimin e teknologjive të avancuara për matjen e cilësisë.

5.Grumbullimi dhe Dërgesa e Materialeve - Pasi guri është ndarë nëpër fraksione të ndryshme, materialet e përfunduar grumbullohen dhe janë të gatshme për t’u dërguar në përdorim të mëtejshëm. Ky proces përfshin paketimin e materialeve dhe sigurimin e cilësisë së tyre për t’u dërguar te klientët. Secili fraksion kalon nëpër një proces kontrolli të cilësisë për t’u siguruar që ai përmbush standardet e industrisë dhe kërkesat e përdoruesve. Kjo përfshin inspektimin për ndotje të mundshme dhe përputhshmërinë me kërkesat e materialeve të përdorura. Materialet e ndara dhe të kontrolluara dërgohen në destinacionet e tyre përfundimtare, ku mund të përdoren për ndërtim, prodhim betoni, ose për aplikime të tjera industriale.

Procesi teknologjik i përpunimit të gurit të fortë në kompaninë "BTP Oil" SH.P.K. përfshin mbledhjen e gurit nga furnizues të tjerë, thërrmimin e gurit në gurthyes dhe ndarjen e materialeve në fraksione të ndryshme, për të prodhuar materiale të cilësisë së lartë për përdorime të ndryshme industriale dhe ndërtimore. Çdo fazë e procesit është e optimizuar për të siguruar që secili fraksion të jetë i përshtatshëm për kërkesat e përdoruesve, duke ruajtur integritetin dhe qëndrueshmërinë e materialeve të përfunduara.




Figura 5. Skema e Procesit Teknologjik të Punës

3.4. Kapaciteti dhe Përmasat e Impiantit

Impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë do të ketë një kapacitet të projektuar 100 m³ ndërsa i realizuar është 70 m³.

3.5 Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Emetimet e pritura gjatë fazës së operimit të një impianti të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë janë ndotës të ndryshëm të ajrit, të tokës dhe ndotës akustik si më poshtë:

Ajri: Gjatë thërrmimit të gurit dhe procesit të ndarjes në fraksione, mund të krijohen pluhura dhe grimca që lëshohen në ajër, sidomos gjatë operacioneve të thërrmimit mekanik.

Uji: Shfrytëzimi i ujit do të përdoret në sasi shumë të vogël për uljen e pluhurave në gurthyes, seperacion e po ashtu edhe për rrugët dhe sipërfaqet manipuluese.

Dheu - gjatë procesit të përpunimit të gurit, mund të krijohen mbetje të ndryshme, që janë blloqe të mbetura që nuk mund të përdoren më tej dhe pluhuri i krijuar nga thërrmimi që mund të depozitohet në dhe.

Flora dhe Fauna – Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë për arsye se në atë zone nuk ka zhvillim të madh të florës dhe faunës.

Ndikimet sociale dhe ekonomike – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku do të hapen vende të reja të punës. Ky Projekt pritet të ndikoj pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale të Komunës së Vushtrisë.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT, THËRRMIMIT DHE SEPERIMIT E GURIT TË FORT

Për të ndërtuar një impiant për përpunim, thërrmim dhe seperim të gurit të fortë, është e rëndësishme të shqyrtohen disa alternativa të arsyeshme. Këto alternativa duhet të marrin parasysh aspektet mjedisore, teknologjike, ekonomike dhe sociale për të siguruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe efektive. Ndërtimin e një impianti për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin të gurit të fortë, është e rëndësishme të shqyrtohen disa alternativa të arsyeshme për të siguruar që projekti të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm, mjedisor dhe teknologjikisht efikas. Më poshtë janë përshkruar disa alternativa të arsyeshme për ndërtimin e këtij impianti:

- **Zgjedhja e Zonave rrafshinore:** Zgjedhja e lokacioni është bërë në zonë rrafshinore ku është tokë ndërtimore dhe hapësirë me prioritet për bujqësi ku pjesa më e madhe e impiantit do të jetë në parcelën ku është tokë ndërtimore me infrastrukturë të zhvilluar, ku është e mundur të lidhet lehtësisht me burime të tjera si energjia dhe uji.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të ujit afër për procesin e përpunimit, thërrmimit dhe seperimin e gurit të fortë, duke siguruar një furnizim të vazhdueshëm dhe të besueshëm.
- Një zonë me industri të ngjashme lejon shkëmbimin e përvojave dhe burimeve, duke krijuar mundësi për inovacione dhe optimizim të proceseve.

Mangësitë:

- Aktivitetet industriale të tjera në zonë mund të rrisin ndotjen e ajrit dhe ujit, duke ndikuar në cilësinë e produktit.

- **Qasja e Mirë:** Lokacioni ofron qasje të shkëlqyer në rrugë dhe infrastrukturë transporti, duke lehtësuar lëvizjen e materialeve dhe produkteve.

Përparësitë:

- Qasja e mirë në rrugë të shpejta redukton ndjeshëm kostot për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e gurit të përpunuar
- Mundësia për të lëvizur shpejt dhe me lehtësi mes impiantit dhe tregjeve të ndryshme rrit efikasitetin dhe shërbimin ndaj klientëve.
- Lehtësirat për transport e bëjnë operacionin më të shpejtë dhe më të besueshëm.

Mangësitë:

- Rrugët e ngarkuara mund të krijojnë vonesa, veçanërisht gjatë orëve të pikut, duke ndikuar në afatshmërinë e operacioneve.
- Rritja e aktivitetit industrial në zonë mund të kërkojë investime të mëtejshme në menaxhimin e trafikut për të siguruar sigurinë.

- **Burime Të Tjera:** Lokacioni ofron akses të lehtë në burime të tjera si energjia elektrike dhe ujë, që janë të domosdoshme për funksionimin e impiantit.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të energjisë afër mund të rezultojë në kosto më të ulëta operative dhe një furnizim të qëndrueshëm energjie.

- Qasja në burime të rinovueshme ose më efikase mund të ndihmojë në reduktimin e kostove të operacioneve dhe ndikimeve mjedisore.

Mangësitë:

- Çdo problem me furnizimin e energjisë mund të ndikojë në operacionet e fabrikës, duke sjellë vonesa dhe humbje financiare.
- Nëse burimet nuk janë të zhvilluar në mënyrë adekuate, mund të kërkojnë investime të mëdha për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.

Secila nga këto alternativa ka avantazhe dhe disavantazhe të vetat. Zgjedhja e alternativës më të përshtatshme varet nga faktorë të tillë si kushtet e vendndodhjes, buxheti, nevojat e komunitetit dhe ndikimet mjedisore. Një analizë e kujdesshme dhe planifikimi strategjik janë të nevojshme për të siguruar që impianti për përpunim, thërrmimi dhe seperim të gurit të fortë të jetë i suksesshëm dhe i qëndrueshëm.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Qyteti i Vushtrisë gjendet në Kosovës, në pjesën qendrore të vendit. Vushtrria është një qytet me rëndësi historike dhe kulturore, dhe është i njohur për industrinë dhe bujqësinë e zhvilluar në rajon. Rajoni është shtëpi për një numër të lartë të specieve të rrezikuara, përfshirë lloje të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Një nga sfidat më të mëdha është ruajtja e habitatit natyror për shkak të zhvillimit urban dhe aktiviteteve bujqësore intensive.

Ndotja e Ajrit: Në qytetet e Kosovës, përfshirë edhe Vushtrinë, ndotja e ajrit është një shqetësim i rëndësishëm. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë problem janë përdorimi i ngrohjes me lëndë djegëse të ngurta (p.sh. dru dhe qymyr), veçanërisht gjatë muajve të dimrit, dhe ndotja nga trafiku i dendur. Kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit, duke shkaktuar nivele të larta të substancave të dëmshme si dioksidi i azotit (NO₂), grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5}, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e banorëve.

Ujërat: Vushtrria ka pasur disa sfida me cilësinë e ujit të pijshëm dhe menaxhimin e burimeve ujore. Sistemet e ujësjellësve dhe kanalizimeve shpesh hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesave për rritjen e popullsisë dhe urbanizimin. Uji i ndotur nga mbetjet urbane dhe bujqësore ka ndikim negativ në lumenjtë dhe burimet ujore të qytetit. Kjo kërkon masa më të forta për ruajtjen dhe pastrimin e ujërave.

Menaxhimi i Mbetjeve: Menaxhimi i mbetjeve është një tjetër sfida e rëndësishme për Vushtrinë. Si në shumë qytete të tjera të Kosovës, infrastruktura për mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve është ende në zhvillim. Grumbullimi i mbeturinave në zona të caktuara dhe shpesh

pastrimi i ngadaltë është një problem i dukshëm. Disa nga këto mbetje janë të ndotura me substanca të dëmshme, të cilat përbëjnë një rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas për riciklimin e mbetjeve ka ndikuar negativisht në cilësinë e mjedisit dhe ka shtuar ndotjen e tokës dhe ujit.

Zhvillimi Urban dhe Ndikimi në Mjedis: Zhvillimi urban në Vushtrri ka sjellë një rritje të kërkesës për burime dhe shërbime si energjia, uji dhe transporti, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis. Urbanizimi dhe ndërtimi i ndërtesave të reja mund të shkaktojnë ndotje të ajrit dhe ujit, si dhe shkatërrim të habitatit natyror. Përdorimi i materialeve ndërtimore që ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe energjinë e shpenzuar për ngrohje janë gjithashtu faktorë që duhet të menaxhohen për të zvogëluar ndikimin e zhvillimit urban në mjedis.

Aktivitetet Ekonomike dhe Ndikimi në Mjedis: Aktivitetet ekonomike, përfshirë bujqësinë, industrinë dhe transportin, kanë një ndikim të konsiderueshëm në mjedis. Vushtrria është e njohur për aktivitetet bujqësore, ku përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike mund të ndotë tokën dhe ujin. Ndërkohë, industria e ndotjes, siç janë fabrikat dhe uzinat, gjithashtu mund të kontribuojnë në ndotjen e ajrit dhe ujit. Aktivitetet e transportit janë gjithashtu një burim i ndotjes, pasi ndihmojnë në shpërndarjen e grimcave të dëmshme që dëmtojnë cilësinë e ajrit.

5.1 Klima dhe Temperatura

Klima e territorit të Vushtrrisë dhe e rrethinave të saj, kushtëzohet nga një mori faktorësh makroklimatikë (gjerësia e pozita gjeografike ndaj detit, masa tokësore, sistemet barike, masat dhe frontet ajrore etj.), si dhe kushteve lokale të terrenit. Kjo komunë, si edhe gjithë Kosova, gjendet gati në qendër të brezit të mesëm verior termik, prandaj klima është e butë, kontinentale mesdhetare dhe kontinentale evropiane. Ky territor karakterizohet me dimra të ftohtë dhe verëra të nxehta, me sasi të madhe të reshjeve dhe thatësi më të mëdha gjatë verës dhe dimrit. Ndryshimet në lartësi mbidetare janë të buta. Temperatura mesatare vjetore është 10.1 °C dhe sasia e reshjeve 650 – 700 mm. Sipas ecurive vjetore të lagështisë relative të ajrit, për regjionin e Vushtrrisë, mund të konstatohet se pjesa prej prillit deri në gusht (68.1-72.8%) ka ajër me vlerë të lagështisë relative të thatë, kurse muajt e tjerë kanë vlerë të lagështisë relative të ajrit mesatarisht të lagësht (75 – 87.2%). Vlera mesatare vjetore e lagështisë relative është 72.2%. I Ngrahja e tokës dhe e ajrit, pra edhe ndryshimet e temperaturës e të faktorëve të tjerë klimatikë qëndrojnë në varshmëri nga ecuritë e vranësirave. Ecuritë vjetore zakonisht qëndrojnë në përputhshmëri me lagështinë relative të ajrit. Muajt me vranësi më të madhe janë: dhjetori (7.2), janari (7.0), shkurti e nëntori që kanë vlerë të njëjtë (6.4), kurse vlera minimale e vranësirave paraqitet në gusht (3.1) dhe korrik (3.8). Vlera mesatare vjetore e vranësisë është

5.4 të dhjetat e qiellit të mbuluar me re. Në territorin e Vushtrrisë, vlerën më të vogël të rastisjeve e kanë erërat nga ana verilindore. Kahja e erërave në këtë komunë në shkallë të lartë është e ndikuar nga morfologjia e terrenit. Shpejtësi më të madhe kanë erërat e drejtimit verior, me vlerë mesatare vjetore prej 2.3m/s dhe më të dobët ato nga perëndimi 1.6 m/s. Sasia mesatare e reshjeve atmosferike është 646mm. Në ecuritë mujore gjatë vitit, reshjet nuk kanë lëkundje të madhe. Stinë me reshje më të shumta janë: vjeshta (173mm) dhe vera (160mm), ndërsa më të pakta dimri (126mm) dhe pranvera (150mm). Sasia e reshjeve rritet me rritjen e lartësisë mbidetare prej 700 – 850mm. Sipas veçorive të regjimit pluviometrik (shpërndarjes së reshjeve gjatë vitit), territori i Vushtrrisë ka veti më të shprehura të regjimit kontinental.

5.2 Karakteristikat Hidrografike

Nga aspekti hidrogeologjik, terreni i komunës së Vushtrrisë cilësohet me veti të dobëta filtruese, me mungesë të horizontit ujëmbajtës me përmasa të rëndësishme eksploatabile dhe ujë dhënie të vogël.

Në komunën e Vushtrrisë janë disa lumenj që kanë rrjedhë të përhershme e disa rrjedhin vetëm kur ka të reshura. Këta lumenj janë: Silnica, Llapi, Brezhnica, Lumkuqi, Studimja, Terstena, Bajaska, Smrekonica.

Të gjithë këta lumenj burimin e kanë në bjeshkët e shalës me përjashtim të lumit Llap i cili rrjedh nga bjeshkët e Llapit, si dhe lumi Silnica cili rrjedhën e ka nga Rrafshi i Kosovës dhe bjeshkët e Çyqavicës. të gjithë këta lumenj, përveç Silnicës, rrjedhin nga ana e djathtë e magjistrales Prishtinë – Vushtri - Mitrovicë dhe Lumi Silnica, kurse nga ana e majtë shtrihen bjeshkët e Çyqavicës ku nuk ka lumenj që kanë rrjedhë të përhershme por janë të varur prej kushteve atmosferike kryesisht prroje dhe prrocka të ndryshme. Dy liqej në fshatin Taraxhë, të cilët kohëve të fundit në temperatura të larta verës thahen. kurse pjesën më të madhe të kohës kanë ujë.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ndërtimi i impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë mund të ketë ndikime mjedisore gjatë gjithë ciklit të tij jetësor, nga sjellja e lëndëve të para të dhe gurit të fortë e deri te përpunimi i tij. Këto ndikime mund të ndryshojnë në varësi të faktorëve të tillë si vendndodhja e impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë.

Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për te eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e Vlerësimit të ndikimit në Mjedis, në këtë rast realizohet duke u bazuar në gjendjen në terren të kompanisë “BTP Oil” SH.P.K.. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: e ajrit, ujit, tokës, kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1 Ndikimet në ajër

Një nga ndikimet kryesore gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit është ndotja e ajrit. Gjatë fazës së ndërtimit, emisionet e pluhurit nga germimi dhe transporti i materialeve, si dhe emisionet nga makineritë e ndërtimit, mund të shkaktojnë ndotje të ajrit. Ky pluhur përmban partikula të imta që janë të dëmshme për shëndetin, sidomos për aparatin respirator të punonjësve dhe për popullatën që jeton afër zonës. Pjesa tjetër e ndotjes ajrore lidhet me emisionet e gazrave nga makineritë e përdorura gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit, si dhe nga proceset e thërrmimit të gurit, ku mund të lëshohen grimcat e pluhurit. Këto substanca ndihmojnë në ndotjen e ajrit dhe kontribuojnë në ndryshimet klimatike, duke përkeqësuar cilësinë e ajrit në zonën përreth.

6.2 Ndikimet në tokë

Tjetër ndikim i mundshëm gjatë ndërtimit dhe operimit është ndotja e tokës. Gjatë ndërtimit, përdorimi i materialeve të ndryshme dhe mbetje ndërtimi, mund të çojë në ndotjen e tokës në rast të derdhjeve ose ruajtjes së pasigurt të substancave të dëmshme. Në operim, procesi i thërrmimit dhe ndarjes mund të prodhojë mbetje të ngurta, të cilat, nëse nuk menaxhohen siç duhet, mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e tokës dhe të shkaktojnë kontaminim të saj. Për këtë arsye, është e rëndësishme të zhvillohen sisteme të menaxhimit të mbetjeve, të cilat përfshijnë grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve për të minimizuar ndikimet mjedisore.

6.3 Ndikimet në ujë

Ndotja e ujit është një tjetër ndikim i rëndësishëm që ndodhin gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit. Gjatë ndërtimit, përdorimi i ujit për proceset e pastrimit dhe larjes mund të shkaktojë derdhje të mbetjeve të materialeve të ndotura, si pluhur dhe kimikate të tjera, që mund të arrijnë në lumenjtë dhe burimet ujore të zonës. Po ashtu, menaxhimi i ujërave të përdorura për operacione industriale është i rëndësishëm për të parandaluar ndotjen e ujit. Në fazën e operimit, impianti mund të përdorë sasi të konsiderueshme uji për spërkatjen e pluhurit gjatë punës në gurëthyes dhe nëse ky ujë nuk trajtohet siç duhet, ai mund të shkaktojë ndotje të ujërave.

6.4 Ndikimet në peizazh

Ndikimet në peizazh gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe ndarjen e gurit të fortë janë të lidhura me ndryshime në pamjen vizuale, strukturën e tokës, shpërndarjen e pluhurit dhe vibracioneve, si dhe ndikimet nga aktivitetet industriale që mund të ndodhin në zonën përreth. Këto ndikime mund të ndikojnë në natyra e peizazhit, por ato mund të minimizohen me masa të kujdesshme për menaxhimin e pluhurit, ndotjes dhe ruajtjen e strukturës natyrore të zonës. Kjo do të sigurojë një balancë mes zhvillimit industrial dhe ruajtjes së peizazhit dhe natyrës përreth.

6.5 Ndikimet në Florë dhe faunë

Operimi i impiantit për përpunim – thërrmim dhe seperim e gurit të fortë ka një ndikim të rëndësishëm në florën dhe faunën e zonës përreth. Aktivitetet e ndërtimit dhe operimit shpesh rezultojnë në heqjen e bimësisë natyrore, duke çuar në shkatërrimin e habitateve të shumë specieve. Shkarkimi i tokës dhe ndryshimi i përdorimit të saj mund të rezultojnë në zvogëlimin e biodiversitetit, me shumë specie që nuk janë në gjendje të adaptohen në kushtet e reja. Shkarkimi i bimësisë natyrore shpesh krijon kushte të favorshme për speciet invazive, të cilat mund të zënë vendin e specieve lokale dhe të shkaktojnë përkeqësimin e ekosistemeve. Zhurmat dhe aktivitetet e natyrës industriale mund të shkaktojnë stres te kafshët, duke ndikuar në sjelljen e tyre, duke i bërë më të kujdesshëm ose duke i detyruar të largohen nga habitatet e njohura.

6.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndërtimi dhe operimi i një impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë ka një gamë të gjerë ndikimesh në vendbanimet dhe popullatën e zonës përreth. Këto ndikime mund të jenë pozitive, por shpesh përballen me sfida dhe pasoja negative. Impianti krijon vende të reja pune, duke ofruar mundësi për punësim në sektorin e ndërtimit, operimit dhe menaxhimit të impiantit. Aktivitetet industriale shpesh stimulojnë zhvillimin e bizneseve të tjera në zonë, si furnizuesit dhe shërbimet lokale. Emisionet e pluhurit nga impianti mund të përkeqësojnë cilësinë e ajrit, duke çuar në probleme shëndetësore për banorët, si sëmundjet respiratore. Aktivitetet industriale prodhojnë nivel të lartë zhurme, që mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e banorëve, duke shkaktuar stres dhe shqetësime. Ngritja e volumit të transportit të materialeve rrit kërkesat për infrastrukturë rrugore, duke mundësuar zhvillimin e rrugëve dhe shërbimeve. Rritja e popullsisë për shkak të punësimit në impiant mund të vendosë presion mbi shërbimet publike, si arsimi, shëndetësia dhe siguria. Rritja e numrit të punëtorëve dhe popullsisë lokale mund të sjellë ndryshime në dinamikën sociale, duke ndikuar

në marrëdhëniet mes komuniteteve. Mundësitë për punësim mund të inkurajojnë angazhimin e individëve në aktivitete sociale dhe zhvillimin e komunitetit.

6.7 Ndikimet nga zhurma

Zhurma është një nga ndikimet mjedisore më të dukshme që vijnë nga operimi i impianteve industriale, përfshirë ato për përpunim – thërrmim dhe seperim të gurit të fortë. Këto ndikime mund të kenë pasoja serioze për shëndetin e popullsisë dhe mirëqenien e saj. Operimi i impiantit mund të krijojë një nivel të përhershëm zhurme nga makineritë dhe pajisjet, që mund të ndikojë në cilësinë e jetës së banorëve të zonës përreth. Ekspozimi i zgjatur ndaj zhurmës operacionale mund të çojë në probleme të shëndetit mendor, si stresi dhe ankthi, dhe probleme fizike, si humbja e dëgjimit.

Tabela 2. Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës

Zhurma	Distanca e lejuar (metra)			
	10	50	100	500
90 db – Niveli i pajisjeve modele	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin prodhues të pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik, si dhe duke pasur parasysh se punohet vetëm gjatë ditës, mund të konkludojm se impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë nuk ka ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të seperacionit.

6.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Në rastet e aksidenteve mjedisore, operimi i një impianti për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis dhe shëndetin e popullatës. Ndikimet e mundshme përfshijnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe pasoja të tjera që mund të jenë të dëmshme për ekosistemet dhe komunitetet lokale. Aksidentet mjedisore mund të dëmtojnë habitate natyrore dhe të shkaktojnë humbje të biodiversitetit, duke ndikuar në popullatat e specieve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme gjatë aksidenteve mjedisore mund të çojë në probleme serioze shëndetësore për popullatën lokale, duke përfshirë probleme respiratore, sëmundje të lëkurës dhe efekte të tjera toksike.

Këto aksidente mund të shkaktojnë ndotje të ajrit, ujit dhe tokës, si dhe të kenë ndikime negative në ekosistemet dhe shëndetin e popullatës. Megjithatë, me zbatimin e masave të

përshtatshme për planifikimin, parandalimin, monitorimin dhe reagimin e shpejtë, këto rreziqe mund të menaxhohen dhe të minimizohen.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundeshe që mund të ndodhin me funksionimin e Impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë nga kompania “BTP Oil” SH.P.K. janë:

- a) Në impiantin për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë nuk do të ketë emetim të zhurmës së pa kontrolluar, e po ashtu edhe të dridhjeve, ndërsa sa i përket dritës nxehtësisë dhe rrezatimit kompania do të ketë shumë më lehtë të zhvillojë punën e sajë. Kompania gjithashtu ka planifikuar vendosjen e kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave dhe rrjedhimisht nuk do të kemi ndotje as nga mbeturinat komunale.
- b) Impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë nga Kompania “BTP Oil” SH.P.K. ka planifikuar të gjitha masat për ruajtjen e shëndetit të njeriut si gjatë funksionimit të sajë, po ashtu impianti mund të përballojë fatkeqësi natyrore siç janë tërmetet, erërat dhe vërshimet. Nuk parashihet që të ketë ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut për arsye se të gjitha instalimet janë kontrolluar dhe po ashtu siguria në punë është parapare të jetë mjaft e lartë.
- c) Sa i përket zonave me rendësi të veçante, Impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë nuk rrezikon ndonjë zonë të veçante apo burim natyror.
- d) Ky Impiant nuk do të ketë ndikim të madh në natyrë për sa i përket gazrave serrë, për arsye se kamionët dhe të gjitha makineritë që do të përdoren do të jenë me pastrues gazra më të larte se Euro 4 të cilat lejohen për përdorim dhe se nuk kanë ndikim në cenueshmerinë e ambientit për rreth, po ashtu nuk kanë ndikim në ndryshime klimatike.
- e) Pasojat e mundshme mund të vijnë nga prishja e kamionëve, derdhja e karburanteve të makinave, nga sistemi elektro-energjetik, sa i përket pasojave ndërkufitare nuk ka fare pasoja, nuk bënë kurrfarë ndotje që të ndikoj në komunat fqinje. Pasojat pozitive janë ato që kompania në fjalë prit të punësojë edhe më shumë punëtorë në administratë dhe prodhim. Ndërsa pasoja negative nuk prit të ketë.

Për sa i përket mbrojtjes së mjedisit kompania ka planifikuar të gjitha masat për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës.

8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.

- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhishë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhishë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Më poshtë do ti përshkruajmë të gjitha masat që duhet marr impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë për t’ju shmangur, parandaluar, zvogëluar apo mënjanuar pasojat negative në Mjedis

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Ndikimet në ajër gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit lidhen kryesisht me pluhurin dhe emisionet e gazrave. Masat për kontrollin e këtyre ndikimeve përfshijnë:

- Përdorimi i pajisjeve të posaçme për kontrollin e pluhurit, siç janë filtrat e pluhurit dhe aspiratorët për të mbledhur grimcat e ngurta që shkaktohen gjatë nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve.
- Përdorimi i rrugëve të optimizuara për transportin e materialeve dhe përdorimi i mjeteve me emisione të ulëta.
- Krijimi i barrierave natyrore dhe mbjellja e bimëve për të thithur pluhurin dhe përmirësuar cilësinë e ajrit.

- Edukimi i punonjësve për përdorimin e metodave ekologjike të qëndrueshme dhe sigurohen që ata të jenë të vetëdijshëm për teknikat e ndihmës për kontrollin e ndotjes.
- Sigurimi që të gjitha makineritë dhe pajisjet të jenë të mirëmbajtura dhe të kalibruara për të ulur emetimet e gazrave të dëmshëm.
- Krijimi i një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm për cilësinë e ajrit në dhe përreth impiantit për të vlerësuar ndikimet dhe për të ndërmarrë veprime të menjëhershme korrigjuese në rast të tejkalimit të kufijve të lejuar.

Impianti përdorë spërkatje gjatë punës në gurëthyes prandaj nuk ka shumë sasi të ndotjes në ajër.

9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Ndikimet në ujë gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit janë të lidhura kryesisht me përdorimin e ujit për spërkatjen e pluhurit dhe menaxhimin e mundshëm të ndotjes. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë përfshijnë:

- Uji përdoret për të kontrolluar shpërndarjen e pluhurit gjatë thërrmimit dhe përpunimit të gurit. Përdorimi i ujit për këtë qëllim minimizon ndotjen e ajrit dhe ndihmon në ruajtjen e cilësisë së ajrit pa krijuar konsum të tepruar të ujit.
- Sigurimi i përdorimit të ujit në mënyrë efikase dhe minimale, për të shmangur shterimin e burimeve ujore.
- Krijimi i sistemeve për mbledhjen dhe trajtimin e ujit të ndotur, si p.sh. nga kullimi i pluhurit ose mbetjet e tjera të procesit, për të parandaluar ndotjen e trupave ujore të afërt.
- Monitorimi i cilësisë së ujit në zonën përreth impiantit për të parandaluar ndotjen e mundshme të burimeve ujore që mund të ndodhin nga aktivitete të tjera industriale ose proceset e përpunimit të gurit.

9.3. Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë

Ndikimet në tokë gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit janë kryesisht të lidhura me shqetësimet që lidhen me deponimin e mbetjeve, shkatërrimin e peizazhit. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë përfshijnë:

- Zgjedhja e vendeve të sigurta dhe të kontrolluara për depozitimin e materialeve të mbetura nga thërrmimi dhe përpunimi i gurit, në mënyrë që të shmanget ndotja e tokës dhe kontaminimi i ujërave nëntokësore.
- Mbetjet e përpunuara duhet të trajtohen në përputhje me standardet mjedisore dhe mund të riciklohen ose shpërndahen në mënyrë të sigurt.

- Implementimi i sistemeve për mbledhjen e pluhurit dhe mbetjeve të tjera për të parandaluar shpërndarjen e tyre në mjedis dhe ndotjen e tokës.
- Mbjellja e bimëve dhe grumbullimi i shkurreve në zonat e prekura për të ndihmuar në riparimin e ekosistemeve dhe për të ruajtur integritetin e tokës.
- Mbështjellja e materialeve dhe mbetjeve për të siguruar që ato nuk shpërndahen në mjedis dhe nuk ndikojnë në cilësinë e tokës.
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së tokës për të identifikuar ndotjet dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese nëse është e nevojshme.

9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma

Zvogëlimi i ndikimeve nga zhurma është një aspekt kyç për ndërtimin dhe operimin e impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë. Kjo është e rëndësishme për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e popullatës lokale si dhe për të minimizuar shqetësimet për faunën.

Më poshtë janë disa masa efektive për zvogëlimin e ndikimeve nga zhurma:

- Përdorimi i pajisjeve moderne dhe të mirëmbajtura që prodhojnë më pak zhurmë; instalimi i barrierave akustike rreth impiantit dhe zonave të ndjeshme për të reduktuar përhapjen e zhurmës.
- Vendosja e një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmës për të siguruar që zhurmat të mbahen brenda kufijve të pranueshëm dhe për të identifikuar shpejt çdo problem.
- Informimi i komunitetit për oraret e punës, aktivitetet e parashikuara që mund të shkaktojnë zhurmë, dhe zbatimi i një plani për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të banorëve.
- Instalimi i pajisjeve të izolimit të zhurmës në impiant dhe pajisje të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës për të reduktuar ndikimet në mjedis dhe në popullatë.

9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Prodhimi Zvogëlimi i ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë nga ndërtimi dhe operimi i një impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e gurit të fortë është thelbësor për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin natyror dhe biodiversitetin. Më poshtë janë disa masa efektive për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë:

- Zgjedhja e një vendndodhje që minimizon ndërhyrjen vizuale dhe ruan pamjet natyrore.
- Ruajtja dhe mbrojtja e pemëve dhe vegjetacionit ekzistues gjatë ndërtimit për të ruajtur pamjen natyrore dhe për të zvogëluar ndikimin vizual.

- Rigjenerimi dhe rehabilitimi i zonave të prekura pas përfundimit të ndërtimit, duke përfshirë mbjelljen e bimëve të reja dhe krijimin e hapësirave të gjelbra.
- Kryerja e një vlerësimi të detajuar të florës lokale për të identifikuar dhe mbrojtur speciet e rrezikuara dhe habitatet e tyre.
- Kufizimi i zonës së ndërtimit për të minimizuar ndikimin në vegjetacionin natyror.
- Rikthimi i vegjetacionit të dëmtuar pas përfundimit të ndërtimit për të siguruar që ekosistemi të rikuperohet.
- Vendosja e rrugëkalimeve për kafshët në zonat e ndërtimit për të siguruar që fauna lokale të mund të lëvizë lirshëm dhe të ketë qasje në habitatet e saj natyrore.
- Planifikimi i korridoreve ekologjike në dizajnin e impiantit për të siguruar që kafshët të kenë rrugë të sigurta për lëvizje.

9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të mbrojtur vendbanimet dhe popullatën nga ndikimet negative që mund të shkaktojë operimi i impiantit, është e rëndësishme të implementohen masa të ndryshme. Më poshtë janë disa strategji efektive:

- Kryerja e një vlerësimi të plotë të ndikimeve potenciale në zonat e banuara përreth për të identifikuar rreziqet dhe shqetësimet. Hartimi i një plani emergjence për situata të papritura, si aksidente ose ndotje, duke përfshirë komunikimin me komunitetin.
- Përdorimi i pajisjeve me emisione të ulëta të zhurmës dhe implementimi i barrierave akustike për të minimizuar ndikimet e zhurmës. Përdorimi i sistemeve për mbulimin e pluhurit dhe menaxhimi i transportit të materialeve për të reduktuar pluhurin.
- Krijimi i rrugëve të dedikuara për transportin e materialeve për të minimizuar ndikimin në rrugët publike dhe në vendbanime. Planifikimi i transportit në orare të caktuara për të minimizuar shqetësimet për banorët dhe për të shmangur trafikun në orët e pikut.
- Ofrimi i informacionit dhe edukimit për banorët mbi aktivitetet e impiantit dhe masat e marra për të reduktuar ndikimet. Krijimi i kanaleve të hapura të komunikimit për ankesat dhe sugjerimet nga komuniteti.
- Vendosja e sistemeve për monitorimin e nivelit të zhurmës, pluhurit dhe ndotjes për të siguruar përputhshmërinë me standardet. Publikimi i raporteve mbi ndikimet mjedisore dhe përmasat që po merren për përmirësim.
- Sigurimi që aktivitetet e impiantit të përputhen me rregullat dhe ligjet lokale për mbrojtjen e popullatës dhe mjedisit.

9.7.Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Për të minimizuar rreziqet dhe për të parandaluar aksidentet mjedisore në impiantin e “BTP Oil” SH.P.K është thelbësore të zbatohen masa të qarta dhe efektive. Më poshtë janë disa nga këto masa:

- **Vlerësimi i Rreziqeve:** Kryerja e një analize të detajuar të rreziqeve për të identifikuar potencialet e aksidenteve dhe ndikimeve mjedisore. Identifikimi i burimeve potenciale të rrezikut si substancat kimike, energjia elektrike dhe makineritë e rrezikshme.
- **Zhvillimi i Planit të Emergjencës:** Hartimi i një plani emergjence për situata si rrjedhjet e lëndëve kimike, zjarret ose ndotjet. Kryerja e stërvitjeve të rregullta për stafin për të siguruar që ata të jenë të gatshëm për të reaguar në situata emergjente.
- **Pajisje Mbrojtëse Personale (PPE):** Sigurimi që të gjithë punonjësit të përdorin pajisje mbrojtëse personale si helmetat, dorezat dhe maskat, për të reduktuar rreziqet nga lëndët e rrezikshme. Ofrimi i trajnimeve për stafin mbi përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse.
- **Monitorimi i Ambientit:** Vendosja e sistemeve për monitorimin e ndotjes, nivelit të zhurmës dhe kushteve mjedisore për të identifikuar rreziqet potenciale. Krijimi i një mekanizmi për raportimin e rreziqeve dhe aksidenteve nga stafi dhe komuniteti.
- **Trajnimi dhe Edukimi:** Ofrimi i trajnimeve të rregullta për stafin në lidhje me sigurinë në punë, procedurat e emergjencës dhe menaxhimin e rreziqeve. Informimi i banorëve mbi procedurat e sigurisë dhe masat që po merren për të mbrojtur mjedisin.
- **Mbrojtja nga Ndotja:** Vendosja e barrierave për të parandaluar përhapjen e substancave të rrezikshme në rast të rrjedhjes. Përdorimi i protokolleve të qarta për ruajtjen dhe përdorimin e lëndëve kimike, për të minimizuar rreziqet.
- **Përmirësimi i Infrastrukturës:** Sigurimi që infrastruktura e impiantit të jetë në përputhje me standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes mjedisore. Instalimi i pajisjeve si sensorët e zjarrit, detektorët e gazit dhe sistemet e alarmit për të monitoruar dhe reaguar ndaj rreziqeve.

Zbatimi i këtyre masave është thelbësor për të siguruar mbrojtjen e punonjësve, mjedisit dhe komunitetit nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore. Një qasje proaktive dhe e organizuar do të ndihmojë në krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë.

9.8. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimit të gurit të fortë kemi edhe mbeturina komunale të cilat krijohen nga punëtorët dhe blerja e produkteve të reja nga

punëtoret, ushqimi dhe blerja e produkteve të tjera. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania i dërgon tek kompanitë e licencuar për menaxhimin e mbeturinave nga komuna e Vushtrrisë.

Tabela 3. Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinės	Shkalla e Rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për Deponim të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Për mbetje të mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat e riciklueshme do të grumbullohen dhe do të dërgohen ose do të merren nga kompanitë të cilat merren me riciklim,
- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komform legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me impiantin e përpunimit, thërmimit dhe seperimin e gurit të fortë, nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi – Shihet Monitorimi dhe raportimi janë aspekte thelbësore të menaxhimit mjedisor për ndërtimin dhe operimin e një impianti për përpunim, thërmim dhe seperimin e gurit të fortë. Këto procese ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret mjedisore, në vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mjedisore. Më poshtë është një përshkrim i metodave dhe praktikave për monitorimin dhe raportimin mjedisor.

a. Monitorimi i Ajrit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ajrit:** Ky monitorim do të kryhet nga kompania e licencuar për matje të emisioneve në ajër.

- **Matja e Emetimeve nga Pajisjet dhe Makineritë:** Monitorimi i emetimeve nga makineritë dhe pajisjet që përdoren gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit.

b. Monitorimi i Ujit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ujit:** Kryerja e analizave të rregullta të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për të ndjekur nivelet e ndotjes dhe për të identifikuar burimet e mundshme të ndotjes.

c. Monitorimi i Zhurmës

- **Matja e Nivelit të Zhurmës:** Përdorimi i pajisjeve për matjen e niveleve të zhurmës në dhe përreth impiantit për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të minimizuar shqetësimet për banorët lokalë.
- **Rishikimi Periodik:** Rishikimi i rregullt i politikave dhe procedurave mjedisore për të siguruar që ato janë të azhurnuara dhe përputhen me praktikatat më të mira dhe kërkesat rregullatorë.

Monitorimi dhe raportimi i pasojave mjedisore nga ndërtimi dhe operimi i impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë, janë thelbësore për të siguruar që ndikimet negative të minimizohen dhe që impianti të operojë në përputhje me standardet dhe rregulloret mjedisore. Kjo kërkon një qasje të integruar që përfshin vendosjen e sistemeve të monitorimit, përgatitjen e raporteve të detajuara, vlerësimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e praktikave mjedisore.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë është një zgjidhje thelbësore për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Ky impiant trajton mbetjet nga gurit i fortë. Përmes procesit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë, këto materiale shndërrohen në fraksione të përdorshme në ndërtimtari, duke kontribuar në ruajtjen e burimeve natyrore dhe reduktimin e mbetjeve.

1. Ndikimet Mjedisore dhe Masat Zbutëse

Ndërsa impianti sjell përfitime të rëndësishme mjedisore, ndërtimi dhe operimi i tij mund të shkaktojë ndikime negative mjedisore, si ndotja e ajrit, tokës, ujit, zhurma, dhe ndikime në peizazh, florë dhe faunë. Për të adresuar këto çështje, janë ndërmarrë masa specifike:

- **Ajër:** Reduktimi i pluhurit dhe emetimit të gazrave ndotëse përmes sistemeve të filtrimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.
- **Tokë:** Menaxhimi i duhur i mbetjeve të rrezikshme dhe parandalimi i erozionit.
- **Ujë:** Monitorimi i cilësisë së ujit dhe parandalimi i rrjedhjeve të kontaminuara.
- **Zhurma:** Përdorimi i pajisjeve të izoluara dhe vendosja e barrierave akustike.
- **Peizazh, Florë dhe Faunë:** Ruajtja e habitateve natyrore dhe mbjellja e bimëve kompensuese.
- **Për Vendbanimet dhe Popullatën:** Informimi dhe transparenca, kufizimi i zhurmës dhe pluhurit, dhe menaxhimi i trafikut.

2. Përfitimet

Impianti jo vetëm që ndihmon në zvogëlimin e mbetjeve dhe ruajtjen e burimeve natyrore, por gjithashtu kontribuon në ekonominë lokale duke krijuar vende pune dhe duke promovuar praktika të qëndrueshme. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbetjeve nga guri i fortë dhe një kontribut të vlefshëm për mbrojtjen e mjedisit.

Andaj, Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit të impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të gurit të fortë, vendodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin lokal janë minimale dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë të mjaftueshme dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për **Pëlqim Mjedisor** sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit “BTP Oil” SH.P.K nga Komuna e Vushtrisë.

13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

TABELA E KOST – BENEFITE E INVESTIMIT NË IMPIANTIN E PERPUNIM, THËRMIM DHE SEPERIMIT GURIT TË FORTË “BTP Oil” SH.P.K.		
Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.	Pranimi i materialit	15,000.00 €
2.	Grilla	11,000.00 €
4.	Seperator i ndarjes se metalit,	14,000.00 €
7.	Ekrane vibruese,	20,000.00 €
8.	Ngarkues	20,000.00 €
Shuma Totale Investive		80,000.00 €

“BTP Oli” SH.P.K